



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. A-437/Prot.
4

Tiranë, më 12 / 09 /2022

URDHËR

Nr. 424, datë 12 / 09 2022

**“PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË LICENCËS SË USHTRIMIT TË
PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES ALMA OSMANAJ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Noterja Alma Osmanaj, e cila e ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 3156 datë 22.04.2011, në Rrethin Gjyqësor Fier dhe me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 3156/1 datë 07.10.2011, është transferuar në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet shkresës me nr. A-437 prot., datë 13.07.2022, ka paraqitur kërkesën e saj për pezullimin e licencës së noterit, me një kohëzgjatje 1 vjeçare, për arsye shëndetësore.

Në kërkesën e paraqitur noterja parashtroi se prej disa kohësh ndodhet në gjendje shëndetësore të rënduar, për të cilën është rekomanduar ndjekja e terapive intensive dhe të vazhdueshme në klinika të specializuara.

Në këto kushte, me qëllim kurimin sipas nevojave shëndetësore, noterja parashtroi kërkesën e saj për pezullimin e licencës së noterit për një periudhë 1 vjeçare, si dhe gadishmërinë e saj për t’ia dorëzuar në administrim arkivën e saj noteriale një noteri tjetër gjatë kësaj periudhe kohore.

Bazuar në pikën 3, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Ministri i Drejtësisë vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës”, Dhoma Kombëtare e Noterisë, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë nesh me nr. A-437/2 prot., datë 25.07.2022, shpreh miratimin për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë noteriale të noterës Alma Osmanaj për periudhën e sipërcituar.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, noterja Alma Osmanaj gjendet përpara parashikimeve të nenit 18, pika 1 sipërcituar, pra përpara rastit kur noteri ka të drejtë të kërkojë që licenca e tij të pezullohet

përkohësisht, për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të germës "a", pikës 1, të nenit 18, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:


1. Pezullimin e përkohshëm të licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Alma Osmanaj, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë, për periudhën kohore 1 vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, për arsye shëndetësore;
2. Caktimin e një noteri për administrimin e arkivës noteriale të noteres Alma Osmanaj, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës sipas parashikimeve në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Stela Lamaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë.
4. Lënien në ruajtje të vulave respektive, vulën e thatë dhe vulën e njomë, të noteres Alma Osmanaj, deri në përfundimin e afatit të pezullimit të Licencës, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë;
5. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit menjëherë pasi të njihet me këtë urdhër, të caktoj datën dhe orën e dorëzimit të arkivit, si dhe të njoftoj noteren z. Alma Osmanaj 5 (pesë) ditë përpara për datën dhe orën e caktuar.
6. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
7. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim

të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij Urdhri.
10. Ky Urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



Ulsi Manja

